



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 790/1 Prot.

Tiranë, më 14 .06 . 2021

**V E N D I M**

**Nr. 109, Datë 14 .06 . 2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 97, datë 25.05.2021, të paraqitur nga A.Q kundër Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes fetare<sup>1</sup>” dhe “çdo shkak tjetër<sup>2</sup>”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash, informon se: “Ka qënë subjekt i Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe i është nënshtruar një hetimi administrativ dhe është vlerësuar sipas shortit të datës 15.11.2018, nga komisionerët, P.Q, V.S dhe L.H. Në cilësinë e relatores ka qënë P.Q dhe me cilësinë e kryesueses së procesit administrativ në seancën dëgjimore ka qënë V.S. Gjatë këtij procesi, nga ky komision, i janë kryer një sërë shkeljesh diskriminuese, si vijon: i. Relatorja P.Q ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe anëtarët e kanë ditur një fakt të tillë dhe nuk kanë informuar sipas detyrimit ligjor, pasi relatorja nuk ka deklaruar faktin e konfliktit të interesit që ankuesi gjykonte çështje me palë në proces motrën e relatores, B.B që ka pasur funksione publike. ii. Mostrajtimi dhe mosshqyrtimi i kërkesës për dhënie dokumentacioni nga KPK e lidhur me çdo shkak tjetër rreth detyrës që ai kryen. Ky diskriminim shprehet në të gjitha format për shkak të detyrës si: refuzim kërkesash, mospasqyrimi i konfliktit të interesit, krijimi i situatave të qëllimshme që ai të gabonte deri sugjerimin për kryerjen e veprave penale dhe administrative deri në rrezikimin e jetës për shkak të COVID 19,

<sup>1</sup> Ankuesi deklaroi se i përket besimit fetar katolik.

<sup>2</sup> Ankuesi pretendon se veprimet kundër tij janë bërë për shkak të detyrës së tij si gjyqtar.

moszbardhja në kohë e vendimit përfundimtar, mosdhënia e procesverbalit në kohë me qëllim që t'i kalonte afati i ankimit si dhe të gjitha format e tjera dhe çdo shkak tjetër të lidhur me detyrën që kryente. iii. KPK, ka kryer veprime diskriminuese djallëzore për të ushtruar trysni dhe shqetësim me qëllim që të mosfestonte festën katolike, ku ai dhe familjarët e tij kanë qenë duke festuar. Dërgimi i pyetësorit nr. 3 me datë 13.04.2020, ditë e hënë, përkon me festën e pashkëve katolike, ditë pushim. iv. KPK ka bërë organizimin e pyetjeve në formën më diskriminuese me qëllim shkaktimin e stresit tek subjekti, konkretisht: A ndodhet ndërtesa në këtë sipërfaqe toke regjistruar në ZVRPP Pukë në pronësinë tuaj me origjinë sipas AMTP nr. 233, datë 02.10.1992, nisur nga shënimi LN GUSHT 2003 (supozuar leje ndërtimi)? v. KPK ka urdhëruar ankuesin me detyra të cilat duheshin të realizoheshin në shkelje të VKM-së nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pasi duhet të lëvizte jashtë ambientit të banimit dhe jashtë rrethit, në kushtet e pandemisë, për të siguruar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, duke rrezikuar që të infektohej me COVID 19. vi. KPK ka bërë parashtrim të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra lidhur me pronësinë. vii. KPK ka bërë zbardhjen e vendimit tej afatit 30 ditor në kundërshtim me nenin 55/7 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka zbardhur vendimin pas 120 ditësh”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e veprimeve diskriminuese të kryera gjatë hetimit administrativ ndaj A.Q nga Komisionerët e KPK-së, P.Q, V.S, L.H dhe zgjidhjen e pasojave.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 3/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”. Ndërsa në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se: “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10021/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

A. Lidhur me pretendimin e A.Q për diskriminim nga ana e KPK-së, gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

A.Q, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshkruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Në përfundim të procesit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me Vendimin nr. 298, datë 17.09.2020 ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit të A.Q.

Subjekti ankues në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka renditur një sërë pretendimesh lidhur me parregullsitë që ishin bërë atij gjatë procesit të rivlerësimit nga ana e komisionit dhe në mënyrë të veçantë nga ana e relatores P.Q, si person që ishte në konflikt interesi me ankuesin.

Referuar njoftimit të publikuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>3</sup>, rezulton se në KPA është regjistruar çështja (JR) nr. 8/2021, datë 24.02.2021 që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit A.Q kundër Vendimit nr. 298, datë 17.09.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Komisioneri vlerëson se reforma për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nëpërmjet ngritjes së institucioneve të posaçme për këtë çështje është e një rëndësie madhore për sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim për të rikthyer besimin e shtetasve në institucionet gjyqësore dhe në demokraci.

Lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve të vetingut, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (çështja nr. 15227/19) është shprehur se: *“Gjykata çmoi se organet e vetingut ishin ngritur dhe formuar në mënyrë të ligjshme dhe kishin qenë «gjykatë e krijuar me ligj», për shkak*

<sup>3</sup> <http://kpa.al/njoftim-464/>

*të bazës ligjore mjaftueshmërisht të qartë (duke iu referuar Kushtetutës dhe Ligjit të Vetingut) e cila parashikonte ngritjen e KPK-së dhe të Kolegjit të Apelimit, për shkak të juridiksionit dhe kompetencave të tyre ekskluzive për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë si dhe të mënyrës së formimit të tyre në çështjen e kërkueses..... Mospërzgjedhja e anëtarëve të organeve të vetingut nga trupa e gjyqtarëve aktualë ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të vetingut, në veçanti në përprjekje për të shmangur ndonjë konflikt të interesit dhe për të garantuar besimin e publikut në këtë proces..... Përsa i përket paanshmërisë, Gjykata vuri re se nuk kishte detyrim të roleve të KPK-së: detyrimi ligjor për të filluar hetimin ishte automatik dhe nuk kushtëzohej nga ngritja e ndonjë «akuze» për shkelje disiplinore ndaj kërkueses; gjetjet paraprake të tij ishin bazuar mbi informacionin që ndodhej në dosje kur ende nuk ishin marrë parasysh argumentet mbrojtëse të kërkueses;<sup>4</sup>”.*

Procesi i vetingut rregullohet nga neni 179/a/b dhe Shtojca A e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligji nr. 84, datë 30.08.2016, i cili ka hyrë në fuqi më 30.10.2016.

Në shkallën e parë procesi i vetingut kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”). Kundër një vendimi të dhënë nga KPK individ mund të paraqesë një apelim në Kolegjin e Apelimit (“KPA”), i cili është një kolegji i specializuar i Gjykatës Kushtetuese.

Kështu në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Nenin 179/b, në nenet 1, 2, 5 dhe 6, parashikohet se: “1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. 2. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. 5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese....6. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë të pavarur dhe të paanshëm”, ndërsa në nenin C, pika 3 të Aneksit, parashikohet se: “3. Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni”.

Në nenin 63/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: Paraqitja e ankimit “1. Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apeliimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.

Kështu, mbështetur në legjislacionin e sipërcituar dhe në kushtet kur Vendimi 298/2020 i KPK është ankimuar nga ana e subjektit ankues, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankuesit për shkelje të parimit të një procesi të rregullt ligjor, trajtohen nga KPA-ja, si organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve, pasi Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë procedurale dhe materiale për shqyrtimin e këtyre pretendimeve.

<sup>4</sup> Referuar Njoftimit për shtyp të lëshuar nga Kancelari i Gjykatës ECHR 051 (2021), DATË 09.02.2021, faqe 3-4.

Referuar legjislacionit të miratuar për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ligjvënësi ka parashikuar dhe përgjegjësinë disiplinore të anëtarit të institucioneve të rivlerësimit, të cilët nuk garantojnë paanësinë gjatë veprimtarisë së tyre. Anëtari i Komisionit dhe gjyqtari i Kolegjit të Apelit mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe rastet e shkeljes disiplinore shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, sipas ligjit.

Kështu në nenin 16/1 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, parashikohet se: *“Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit. Anëtari i institucionit të rivlerësimit mban përgjegjësi disiplinore, veçanërisht për shkak të: 1. Mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, kur ka dyshime të arsyeshme për ekzistencën e rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit, sipas legjislacionit në fuqi dhe nëse anëtari është në dijeni të rrethanave të tilla”*, ndërsa në nenin 27, pika 1 dhe 3, përcaktohet se: Garantimi i paanësisë. *“1. Anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaron dhe shmang çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit”. Çdo vendim i marrë në një situatë konflikti interesi, përveç pasojave ligjore në procesin e vendimmarrjes, përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji. 3. Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i subjektit ankues për situatën e konfliktit të interesit të anëtares së komisionit P.Q dhe mosdeklamit të saj për këtë, është një pretendim i cili shqyrtohet/gjykohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, e për pasojë nuk mund të pranohet e nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Bazuar në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipër cituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b dhe 10 të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 97, datë 25.05.2021, të paraqitur nga shtetasi A.Q.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**